

KËRKIME GJUHËSORE

Merita SAUKU BRUCI

EMIRA-T E SANTORIT DHE DISA HIPOTEZA LIDHUR ME TRANSMETIMIN E TEKSTIT

Udha e kërkimeve dhe studimeve mbi tekstet e vjetra në gjuhën shqipe është e gjatë, e vështirë dhe plot befasi për një studiues filolog, i cili merr përsipër të qëmtojë e të hetojë me kujdes rrugëtimin e tyre që nga momenti kur janë shkruar e deri në ditët e sotme. Sa më shumë përparojmë në kohë, aq më e paktë bëhet mundësia për të rënë në gjurmët e origjinalit, dhe aq më shumë shtohen mundësitë për t'iu shmangur atij. E qëllimshme ose jo, shmangia nga vullneti i fundmë i autorit na çon në një interpretim të gabuar të fakteve historike, gjuhësore a letrare dhe nuk na jep një tekst të sigurt mbi të cilin mund të ndërtohen studime të mëtejshme e të nxirren përfundime të patëmeta.

Për të ilustruar këtë problematikë, shumë të pranishme në trajtimin e trashëgimisë sonë letrare, kemi zgjedhur të hulumtojmë mbi dramën e parë të shkruar në gjuhën shqipe deri më sot: “EMIRA” e Franqisk Anton Santorit. Kërkimet nëpër biblioteka, arkiva shtetërore e familiare na paraqesin këtë larmi *Emira-sh*. Për lehtësi konsultimi të dhënat i kemi paraprirë nga një sigël dalluese:

EDK (dorëshkrime origjinale, Fondi “Francesco Antonio Santori”, Biblioteka Qytetëse e Kozencës. Hartuar 1864)

EDF (dorëshkrim, burimi I. Fortino, fotokopje e dorëshkrimit në zotërim të Papas Xhuzepe Ferrarit)

EDI (Dorëshkrim, burimi i paditur, fotokopja ndodhet në arkivin e Institut të Gjuhësisë)

EDB (Dorëshkrim, burimi Biblioteka Kombëtare, fotokopje disa skenave të aktit V që ndodhet në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë, sigla Jls/4.)

EDR: *I dieci passati per le armi in Pizziglia* drama del Calogero Padre Fra Antonio Santori da S. Caterina, në *Fiamuri Arbërit – Bandiera dell’Albania*, periodico mensile diretto da Girolamo De Rada, Corigliano Calabro, Tip. Letteraria, 1883. f.203-248

EKZ: Monografi mbi Anton Santorin dhe drama “Emira”. Shtypshkrime, 250 f. Burimi Fondi “Ziaudin Kodra”, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, QNSA, Tiranë)

EZK: F.A. Santori, *Emira* (Dramë) dhe disa vjersha. (Teksti në origjinal dhe i vënë në gjuhën e sotme) Me një hyrje rreth jetës dhe veprave të auktorit nga Ziaudin Kodra. Tiranë, NSHB “Naim Frashëri”, 1959.

EFS: Antonio Francesco Santori, *Emira*, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano, Comune di Cerzeto/Qana, Biblioteca Comunale, Scuola tip. Italo-Orientale ‘S. Nilo’, Grottaferrata, 1984, 291 faqe.

ERK: Frangjisk Anton Santori: Vepra 2 *Emira* (Dramë në pesë akte) Prishtinë, Rilindja, 1994. Botim me tekst përballë: ai i transkriptuar nga Françesko Solano

në të majtë dhe me tekst të përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, Redaktor Fahredin Gunga.

ELSH: K. Kodra, R. Filipi, S. Çapaliku, *Letërsia Shqiptare* 2, Tiranë, Shblsh, 2003 (botim i parë 1998, ribotime 2000, 2001, 2002, 2003.)

EKK = Frangjisk Anton Santori, *Emira*, Dramë në pesë akte, Vepra (përshtaja në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, redaktori Klara Kodra, Tiranë Argeta –LMG, 2006.

Siç shihet nga kjo listë e paraqitur, pasi ka grumbulluar materialin, filologut i shtrohet si detyrë të vendosë një rregull në këtë linjë transmetimi, të ndërtojë disa pista shqyrtimi, të parashtrojë disa hipoteza dhe të rindërtojë rrugën që teksti letrar ka ndjekur nga origjinali, duke dalluar e veçuar ato botime që për arsye nga më të ndryshmet paraqesin shmangie të theksuara nga vullneti i autorit, që pasqyrohet në dorëshkrimin e tij.

Pista e parë që mund të ndiqet dhe problemi që duhet të zgjidhet do të ishte: nga cili dorëshkrim origjinal burojnë dhe a ka ndryshime mes vetë dorëshkrimeve, pra kemi të bëjmë me të njëjtin dorëshkrim apo me variante të ndryshme të hartuara nga vetë autori në kohë të ndryshme ? (Shih tabelën 1: EDI, EDF, EDK)

Kemi zgjedhur për ilustrim të njëjtin fragment, shkëputur nga akti I, skena I, nga të gjitha botimet e sipërpërmendura, të ndara në gjashtë tabelat shoqëruese që korrespondojnë me gjashtë pistat e shqyrtimit. Transkriptimi nga dorëshkrimet është yni.

Sic shihet edhe nga krahasimi i fragmentit rezulton se dorëshkrimet EDI dhe EDF përputhen, me gjasë faksimilet pasqyrojnë të njëjtin dorëshkrim origjinal, ndërsa EDK ka ndryshime. Kaligrafia e origjinalit është e njëjta, i takon Santorit, por mund të kemi të bëjmë me një variant tjetër të veprës së hartuar nga vetë ai.

Kjo do të na çonte në një *pistë të dytë* shqyrtimi. Është e dokumentuar që De Rada botoi për herë të parë 3 aktet e para të *Emirës* në revistën e tij *Fiamuri Arbrit* në 1883. Na duhet të shohim se në cilin dorëshkrim është mbështetur De Rada në botimin e tij. Siç shihet nga tabela përkatëse (shih tab.2) me bazë krahasimi EDI/EDF, EDK dhe EDR, teksti i përdorur nga De Rada ndryshon dukshëm nga ai i Santorit. Të ketë pasur një tjetër dorëshkrim në dispozicion apo De Rada i ka njohur vetes të drejtën të ndërhyjë në tekst?

Pista e tretë e shqyrtimit do të na lejojë të ndjekim të njëjtën linjë me De Radën. Në 1959 Ziaudin Kodra boton tri aktet e dramës *Emira*, në variantin arbërisht me tekstin përballë në një përshtatje në shqipen e sotme. Fakti që duhet të shqyrtohet me kujdes është: mbi cilin variant është bazuar Ziaudin Kodra dhe çfarë ndryshimesh ka pësuar teksti nga transkriptimi i De Radës e deri tek përshtatja. Tabela e tretë me bazë krahasimi EDR, EZK, EZK na përcjell ndryshime më të pakta nga varianti i De Radës dhe një shmangie të dukshme në përshtatjen në shqipen e sotme (shih tab. 3).

Botimin e plotë të pesë akteve të dramës e gjejmë në 1984, nga prof. Francesco Solano, në Kalabri. Kjo na mundëson të futemi në një *pistë të katërt* shqyrtimi: në cilin nga dorëshkrimet që ne kemi në dorë është mbështetur Solano për të transkriptuar tekstin e tij. Përgjigjen do të mund ta gjejmë pas shqyrtimit të tabelës gjegjëse me bazë krahasimi EDI/EDF, EDK, EFS. (shih tab.4). Varësia nga dorëshkrimet EDI/EDF është e dukshme por mbetet për t'u parë nëse Solano ka zgjedhur të ndërhyjë në format gjuhësore të autorit, apo ka pasur një tjetër dorëshkrim në dorë?

Mbi këtë botim të Solanos është mbështetur edhe një botim i shtëpisë botuese *Rilindja*, Prishtinë, 1994, i cili na sjell përpos tekstit në arbërisht edhe një përshtatje në shqipen e sotme nga Ramiz Kelmendi. Mbi këtë përshtatje të Kelmendit është ndërtuar dhe një redaktim i Klara Kodrës botuar në 2006 në Tiranë. (shih tab. 5)

Le t'i hedhim një sy tabelës me bazë krahasimi EFS, ERK, EKK, e cila përbën njëkohësisht edhe *pistën e pestë* të shqyrtimit, për të kuptuar se sa hepohet Kelmendi nga origjinali, si është transmetuar dhe çfarë ndryshimesh ka pësuar teksti nga teksti bazë i Solanos, tek Ramiz Kelmendi e Klara Kodra, në ç'formë i ka ardhur publikut dhe lexuesit të thjeshtë.

Pista e gjashtë dhe e fundit e shqyrtimit ka të bëjë me një problem që nuk duhet anashkaluar asesi. Si është transmetuar ky tekst në librat e letërsisë? Në ç'formë i ka ardhur nxënësve të shkollave të mesme? Nga moria e teksteve shkollore kemi përzgjedhur atë që i afrohej një varianti në arbërisht. Tabela n. 6 me bazë krahasimi EDR, EZK, ELSH përcakton varësinë e tekstit prej variantit të De Radës.

Përkshuam kështu një periudhë paraprake shqyrtimi e përzgjedhjeje për të përcaktuar pikënisjen e një teksti letrar dhe kujdesin që duhet treguar për të evituar humbjet dhe ndërhyrjet që pëson një tekst i dhënë gjatë botimit e ribotimit të tij. Analiza më të hollësishme fonologjike, morfologjike e sintaksore na mundësojnë të zgjidhim problemin e madh: a kemi të bëjmë me dramën EMIRA të Santorit apo me dramën EMIRA *sipas* Santorit.

MERITA SAUKU-BRUCI

Tabela 1.

EDI (Dorëshkrim, burimi i paditur, fotokopja që ndodhet në arkivin e Institut të Gjuhësisë)	EDF (Dorëshkrim, burimi Fortino, fotokopje e dorëshkrimit në zotërim të Papas Xhuzepe Ferrarit)	EDK (dorëshkrime origjinale, Fondi “Francesco Antonio Santori”, Biblioteka Qytetëse e Kozencës.)
<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kurë arvove? Nënk të pë të vinje këtej aposhtaz. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims kohë çë jamë këtu. Prei këtij limti gjenë barez delet, e kullosëtin dica, pra ç’u potisëtin. <i>Emira:</i> E ti çë bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të sempri shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedërë çë së ntëndet kurraï. Ndo t’ish prë të, duoj të serposnja një parë kalluciet ditën. Ka herë çë mbllidhemi mbrëmanet, parën të pieturë çë më bënë është kio: “Shërbeve sod, o fëite je shtruorë tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietët çë serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë çë s’kë straposëme. Ndo t’i përgjegjsha një gjims fialë, njenje vinej lufta! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmblesitë!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kurë arvove? Nënk të pë të vinje këtej aposhtaz. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims kohë çë jamë këtu. Prei këtij limti gjenë barez delet, e kullosëtin dica, pra ç’u potisëtin. <i>Emira:</i> E ti çë bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të sempri shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedërë çë së ntëndet kurraï. Ndo t’ish prë të, duoj të serposnja një parë kalluciet ditën. Ka herë çë mbllidhemi mbrëmanet, parën të pieturë çë më bënë është kio: “Shërbeve sod, o fëite je shtruorë tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietët çë serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë çë s’kë straposëme. Ndo t’i përgjegjsha një gjims fialë, njenje vinej lufta! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmblesitë!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur’ arvove? Nënk të pë të shkonje aposhtaz nka llaka. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims herë çë jamë këtu. Pas këtij limëti gjenë ca barez delet, e kullosëtin dica, prana ç’u potisëtin. <i>Emira:</i> E ti çë bëre? <i>Kallina:</i> O motrëmë, diu si k’anë m’arruri unda e këntova një çik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të pathër shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedërë çë së ntëndet kurraï. Nd’ish prë të, doj të serposënja një parë kalluciet ditën. Ka herë çë mbllidhemi mbrëmënet, të parën të pieiturë çë më bënë është kio: “Shërbeve sod, o fëite tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietit çë serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë çë së kë straposëme. Ndose t’i përgjegjësja ndonjë fial, njenje zëj jushtria! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartiratë se ëmblesitë!

Tabela 2.

EDI/EDF (Dorëshkrime), (transkriptimi nga dorëshkrimet është yni)	EDK (dorëshkrime origjinale, Fondi “Francesco Antonio Santori”, Biblioteka Qytetëse e Kozencës.)	EDR: I dieci passati per le armi in Pizziglia drama del Calogero Padre Fra Antonio Santori da S. Caterina, në Fiamuri Arbërit – Bandiera dell’Albania, Tekst (transkriptimi ynë)
<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kurë arrove? Nën� të pë të vinje këtej aposhtaz. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims kohë çë jamë këtu. Prej këtij limti gjenë barez delet, e kullosëtin dica, pra ç’u potisëtin. <i>Emira:</i> E ti çë bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të sempri shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedërë çë së ntëndet kurrai. Ndo t’ish prë të, duoj të serposnja një parë kalluciet ditën. Ka herë çë mbllidhemi mbrëmanet, parën të pieturë çë më bënë është kio: “Shërbeve sod, o fjëite je shtruorë tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietët çë serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë çë s’kë straposëme. Ndo t’i përgjegjsha një gjims fjalë, njenje vinej lufta! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmblësitë!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur’ arrove? Nën� të pë të shkonje aposhtaz nka llaka. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims herë çë jamë këtu. Pas këtij limëti gjenë ca barez delet, e kullosëtin dica, prana ç’u potisëtin. <i>Emira:</i> E ti çë bëre? <i>Kallina:</i> O motrëmë, diu si k’anë m’arruri unda e këntova një cik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të pather shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedërë çë së ntëndetë kurrai. Nd’ish prë të, doj të serposënja një parë kalluciet ditën. Ka herë çë mbllidhemi mbrëmënet, të parën të pieiturë çë më bënë është kio: “Shërbeve sod, o fjëite tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietit çë serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë çë së kē straposëme. Ndose t’i përgjegjësja ndonjë fjal, njenje zëj jushtria! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartiratë se ëmblësitë!	<i>Emi[ra]:</i> Ku jë? <i>Kal[lin]:</i> Këtu, te kroi. <i>Emi[ra]:</i> Kūr arrëvove? Nën� të pë të zdrepëshe këtej aposhtaz. <i>Kal[lin]:</i> S’ka një gjims herie çë jam këtu. Te këta ca barith deljet një shkararen. [<i>Emira:</i> E ti çë bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emi[ra]:</i> E po si, pā furk gjënde? Jot’ëm së të shtrëngon të mos e shërbeç si mëma ime? <i>Kal[lin]:</i> Maide! Çë thua Emir? Ajo është një klëshedhër çë s’ndëndet kurrai. Ndë ish për të, doi të gatia një pā çarapa ditën. Nkē hēr çë mbjidhem mbrëmanet, parën të pietur çë më bën është këjo: “Shërbeve sod? O fjeite e shtruar tek ndonjë sqilj o ndën hë? Ku ë çarapa çë gate? U rrë qet; se ndë dē t’i përgjegjësja një gjims fjalje mbiatë zëhej ljufta. <i>Emi[ra]:</i> Eh! Motëra ime, ashtu ë e bënur gjella: jān keq më shumë thartirat se ëmbëljsirat.

MERITA SAUKU-BRUCI

Tabela 3.

EDR: I dieci passati per le armi in Pizziglia drama del Calogero Padre Fra Antonio Santori da S. Caterina, në Fiamuri Arbërit – Bandiera dell’Albania, Tekst (transkriptimi ynë)	EZK: F.A. Santori, <i>Emira</i> (Dramë) dhe disa vjersha. 1959 Transkriptimi i Z. Kodrës tekstit të botimit nga De Rada, f.28-29	EZK: F.A. Santori, <i>Emira</i> (Dramë) dhe disa vjersha. 1959 Përshtatja në gjuhën e sotme nga Z. Kodra tekstit të De Radës, f.28-29
<i>Emi[ra]:</i> Ku jë? <i>Kal[lina]:</i> Këtu, te kroi. <i>Emi[ra]:</i> Kūr arrëvove? Nënk të pë të zdrepëshe këtej aposhtaz. <i>Kal[lina]:</i> S’ka një gjims herie çe jam këtu. Te këta ca barith deljet një shkararen. [<i>Emira:</i> E ti çe bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emi[ra]:</i> E po si, pā furk gjënde? Jot’ ëm sē të shtërngon të mos e shërbeç si mëma ime? <i>Kal[lina]:</i> Maide! Çë thua Emīr? Ajo është një klëshedhër çe s’ndëndet kurrai. Ndë ish për të, doi të gatia një pār çarapa ditën. Nkā hēr çe mbjidhem mbrëmanet, parën të pietur çe më bën është këjo: “Shërbeve sod? O fjeite e shtruar tek ndonjë skjilji o ndën hē? Ku ë çarapa çe gate? U rri kjet; se ndë dē t’i përgjegjësja një gjims fjalje mbiatë zëhej ljufta. <i>Emi[ra]:</i> Eh! Motëra ime, ashtu ë e bënur gjella: jān kekj më shum thartirat se ëmbëljsirat.	<i>Emira:</i> Ku je? <i>Kalina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur arrëvove? Nënk të pe të sdrepëshe këtej aposhtaz. <i>Kalina:</i> S’ka një gjims herie çe jam këtu. Te këta ca barith deljet njo shkararen. [<i>Emira:</i> E ti çe bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Jot’ ëmë s’të shtërngon të mose shërbeç si mëma ime? <i>Kalina:</i> Maide! Çë thua Emirë? Ajo është një klëshedhër çe s’ndëndet kurrai. Ndë ish për të, doi të gatia një parë çarapa ditën. Nka herë çe mbjidhem mbrëmanet, parën të pietur çe më bën është këjo: “Shërbeve sod? O fjeite e shtruar tek ndonjë skjilji o ndënë hje? Ku ë çarapa çe gate? U rri kjet; se ndë t’i përgjegjësja një gjims fjalje mbiatë zëhej ljufta. <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu ë e bënur gjella: janë kekj më shumë thartirat se ëmbëljsirat.	<i>Emira:</i> Ku je? <i>Kalina:</i> Këtu, te Kroi. <i>Emira:</i> Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritshe këtej poshtë. <i>Kalina:</i> S’ka një copë herë që jam këtu. Te ky bar ja delet po kullosin. [<i>Emira:</i> E ti çe bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Jot’ëmë s’të shtërngon të punosh gjithnjë, si im më? <i>Kalina:</i> Ç’ thua, diç zotin edhe ti Emirë? Ajo është një kulshedër çe nuk ngopet kurrë. Po t’ish si thotë ajo, do të donte të pregatisja një palë çorape ditën. Çdo herë kur mblidhemi në mbrëmje, të parën të pyetur që më bën është kjo: “Punove sot, apo fjete e shtruar në diell apo në ndonjë hije? Ku e ke çorapin që ke bërë?” Unë rri e qetë se po t’i përgjegjësja edhe një gjysmë fjale, m’atë ças do të zihej lufta! <i>Emira:</i> Eh, motra ime, ashtu është bërë jeta: ka më shumë thartira se ëmbëlsira!

Tabela 4.

EDI/EDF (Dorëshkrime), burimi Jorgo Bullo, Fortino	EDK (dorëshkrime originale, Fondi “Francesco Antonio Santori”, Biblioteka Qytetëse e Kozencës.)	EFS: Antonio Francesco Santori, <i>Emira</i> , Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano.
<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kurë arvove? Nën k të pë të vinje këtej aposhtaz. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims kohë që jam këtu. Prej këtij limti gjenë barez delet, e kullosët in dica, pra ç’u potisët in. <i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të sempri shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedër që së ntëndet kurra. Ndo t’ish prë të, duoj të serposnja një parë kalluciet ditën. Ka herë që mbllidhemi mbrëmanet, parën të pieturë që më bënë është kjo: “Shërbeve sod, o fjërthe je shtruorë tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietët që serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë që s’kë straposëme. Ndo t’i përgjegjësja një gjims fjalë, njenje vinej lufta! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmblësitë!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur’ arvove? Nën k të pë të shkonje aposhtaz nka llaka. <i>Kallina:</i> Shkoi thomse një gjims herë që jam këtu. Pas këtij limëti gjenë ca barez delet, e kullosët in dica, prana ç’u potisët in. <i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëmë, diu si k’anë m’arruri unda e këntova një cik! <i>Emira:</i> E po si, pa furk gjënde? Jot’ëmë së të shtrënkone të pathër shërbeçë, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Maide! Çë thua, Emirë? Ajo është një kushedër që së ntëndet kurra. Nd’ish prë të, doj të serposënja një parë kalluciet ditën. Ka herë që mbllidhemi mbrëmënet, të parën të pieiturë që më bënë është kjo: “Shërbeve sod, o fjërthe tek ndonjë shëllëz o hë? Ku janë kallucietët që serpose?” U rrë qet, e ajo zë një storë që së k straposëme. Ndose t’i përgjegjësja ndonjë fjal, njenje zëj jushtria! <i>Emira:</i> Eh! Motëra ime, ashtu është e bënurë gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmblësitë!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur arrëvove? Nën g të pé të vinje këtej apòsh-taz. <i>Kallina:</i> S’k thomse një gjysmë koh’je që jam këtu. Prëj këtij limti gjenë barez delet, e kullost in dicà, pra ç’u potist in. <i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëmë, di u si k’anë m’arruri ënda e këndova një çikë! <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Jot’ëmë s’të shtrëngon të sembri shërbeç, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Majde! Ç’ thua, Emirë? Ajò është një Kushedër që s’ ndëndet kurra. Ndo t’ish prë të, duoj të serposnja një parë kallucjetë ditën. Ka herë që mbllidhemi mbrëmanet, parën të pyejtur që më bën është kjo: “Shërbeve sod, o fjërthe je shtruor tek ndonjë shëllëzë o hje? ku janë kallucjetët që serpose?” U rrë qetë, e ajo zë një storë që s’k straposme. Ndo t’i përgjegjësja një gjysmë fjalje, njenjë vinej lufta! <i>Emira:</i> Eh! Motra ime, ashtu është e bënur gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmblësitë!

Tabela 5.

EFS: Antonio Francesco Santori, <i>Emira</i>, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano.	ERK: F. A. Santori: <i>Vepra 2 Emira</i> 1994. Përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga R. Kelmendi.	EKK = F. Santori, <i>Emira</i>, parathënie e redaktori Klara Kodra
<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kallina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur arrëvove? Nëng të pé të vinje këtej apòshtaz. <i>Kallina:</i> S'ká thomse një gjysmë koh'je që jam këtu. Prëj këtij limti gjenë barez delet, e kullostin dicà, pra ç'u potistin. <i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëmë, di u si k'anë m'arruri ënda e këndova një çikë! <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Jot'ëmë s'të shtrëngon të sembri shërbeç, si mëma ime! <i>Kallina:</i> Majde! Ç' thua, Emirë? Ajo është një Kushedër që s' ndëndet kurrë. Ndo t'ish prë të, duoj të serposnja një parë kallucjetë ditën. Ka herë që mblidhemi mbrëmanet, parën të pyejtur që më bën është kjo: "Shërbeve sod, o fjëjte je shtruor tek ndonjë shëllëzë o hjë? ku janë kallucjetët që serpose?" U rrí qetë, e ajo zë një storí që s'ká straposme. Ndo t'i përgjegjësja një gjysmë fjalje, njenjë vinej lufta! <i>Emira:</i> Eh! Motra ime, ashtu është e bënur gjella! Janë keq më shumë thartirat se ëmbëlsitë!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kalina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritje këtej poshtë. <i>Kalina:</i> S'ka, them, një gjysmë ore që jam këtu. Te ky gardh gjetën pak bar delet e mia ndaj i lëshova të kullosin paksa pasi pinë ujë. <i>Emira:</i> Po ti që bëre? <i>Kalina:</i> Oj, moj motra ime, edhe vetë s'di nga m'erdhi ëndja dhe këndova një çikë! <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Vallë jot'ëmë nuk të shtrënguaka të punosh gjithnjë, si mëma ime! <i>Kalina:</i> Pa shih, pa shih! Ç' thua, Emirë? Ajo është një kulshedër që nuk ngopet kurrë. Po të qe e mundur, do t'ia mirrte mendja që të mbaroja një palë çorapë në ditë. Çdoherë tek mblidhemi në mbrëmje, të parën pyetje që më bën është kjo: "Punove sot, apo ia krise gjumit e shtrirë në diell a nën hije? Ku i ke çorapët që i mbarove?" Unë rri e qetë, e ajo zë e më mban litani që s'ka të sosur. Po t'i përgjigjesha, qoftë edhe me një gjysmë fjale, përnjëherë do të krise lufta! <i>Emira:</i> Eh, motra ime, kështu e ka kjo jetë: shumë më tepër ka thartira sesa ëmbëlsira!	<i>Emira:</i> Ku jë? <i>Kalina:</i> Këtu, te kroi. <i>Emira:</i> Kur erdhe? Nuk të pashë të zbrisje këtej poshtë. <i>Kalina:</i> S'ka, them, një gjysmë ore që jam këtu. Te ky gardh gjetën pak bar delet e mia ndaj i lëshova të kullosin paksa pasi pinë ujë. <i>Emira:</i> Po ti që bëre? <i>Kalina:</i> Oj, moj motra ime, edhe vetë s'di nga më erdhi ëndja dhe këndova një çikë! <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjindesh? Vallë jot'ëmë nuk të shtrëngoka të punosh gjithnjë, si mëma ime! <i>Kalina:</i> Pa shih, pa shih! Ç' thua, Emirë? Ajo është një kuçedër që nuk ngopet kurrë. Po të qe e mundur, do t'ia merrte mendja që të mbaroja një palë çorape në ditë. Çdoherë tek mblidhemi në mbrëmje të parën pyetje që më bën është kjo: "Punove sot, apo ia krise gjumit e shtrirë në diell a nën hije? Ku i ke çorapët që i mbarove?" Unë rri e qetë, e ajo zë e më mban litani që s'ka të sosur. Po t'i përgjigjesha, qoftë edhe me një gjysmë fjale, përnjëherë do të kërciste lufta! <i>Emira:</i> Eh, motra ime, kështu e ka kjo jetë: shumë më tepër ka thartira sesa ëmbëlsira!

Tabela 6.

EDR: I dieci passati per le armi in Pizziglia drama del Calogero Padre Fra Antonio Santori da S. Caterina, në Fiamuri Arbërit – Bandiera dell’Albania, Tekst (transkriptimi ynë)	EZK: F.A. Santori, <i>Emira</i> (Dramë) dhe disa vjersha. 1959 Përshtatja në gjuhën e sotme nga Z. Kodra tekstit të De Radës, f.28-29	ELSH: K. Kodra, R. Filipi, S. Çapaliku, <i>Letërsia Shqiptare 2</i>, Tiranë, Shblsh, 2003 (botim i parë 1998, ribotime 2000, 2001, 2002, 2003.)
<i>Emi[ra]:</i> Ku je? <i>Kal[lina]:</i> Këtu, te kroi. <i>Emi[ra]:</i> Kūr arrëvove? Nënk të pë të zdrepëshe këtej aposhtaz. <i>Kal[lina]:</i> S’ka një gjims herie që jam këtu. Te këta ca barith deljet një shkararen. [<i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emi[ra]:</i> E po si, pā furk gjënde? Jot’ëm sē të shtërngon të mos e shërbeç si mëma ime? <i>Kal[lina]:</i> Maide! Çë thua Emīr? Ajo është një klëshedhër që s’ndëndet kurrai. Ndë ish për të, doi të gatia një pār çarapa ditën. Nkā hēr që mbjidhem mbrëmanet, parën të pietur që më bën është këjo: “Shërbeve sod? O fjeite e shtruar tek ndonjë skjiljī o ndën hē? Ku ë çarapa që gate? U rrī kjet; se ndë dē t’i përgjegjësja një gjims fjalje mbiatë zëhej ljufta. <i>Emi[ra]:</i> Eh! Motëra ime, ashtu ë e bënur gjella: jān kekj më shumë thartirat se ëmbëljsirat.	<i>Emira:</i> Ku je? <i>Kalina:</i> Këtu, te Kroi. <i>Emira:</i> Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritshe këtej poshtë. <i>Kalina:</i> S’ka një copë herë që jam këtu. Te ky bar ja delet po kullosin. [<i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Jot’ëmë s’të shtërngon të punosh gjithnjë, si im më? <i>Kalina:</i> Ç’ thua, diç zotin edhe ti Emirë? Ajo është një kulshedër që nuk ngopet kurrë. Po t’ish si thotë ajo, do të donte të pregatisja një palë çorape ditën. Çdo herë kur mblidhemi në mbrëmje, të parën të pyetur që më bën është kjo: “Punove sot, apo fjete e shtruar në diell apo në ndonjë hije? Ku e ke çorapin që ke bërë?” Unë rri e qetë se po t’i përgjegjesha edhe një gjysmë fjale, m’atë ças do të zihej lufta! <i>Emira:</i> Eh, motra ime, ashtu është bërë jeta: ka më shumë thartira se ëmbëlsira!	<i>Emira:</i> Ku je? <i>Kalina:</i> Këtu, te Kroi. <i>Emira:</i> Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritshe këtej poshtë. <i>Kalina:</i> S’ka një copë herë që jam këtu. Te ky bar ja delet po kullosin. [<i>Emira:</i> E ti që bëre? <i>Kallina:</i> O motrëm, diu si k’anë m’arruri ënda e këntova një cik! (mungon)] <i>Emira:</i> E po si, pa furkë gjënde? Jot’ëmë s’të shtërngon të punosh gjithnjë, si im më? <i>Kalina:</i> Ç’ thua, diç zotin edhe ti Emirë? Ajo është një kulshedër që nuk ngopet kurrë. Po t’ish si thotë ajo do të donte të pregatisja një palë çorape ditën. Çdo herë kur mblidhemi në mbrëmje, të parën të pyetur që më bën është kjo: “Punove sot, apo fjete e shtruar në diell apo në ndonjë hije? Ku e ke çorapin që ke bërë?” Unë rri e qetë se po t’i përgjegjesha edhe një gjysmë fjale, m’atë çast do të zihej lufta! <i>Emira:</i> Eh, motra ime, ashtu është bërë jeta: ka më shumë thartira se ëmbëlsira!